



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
KOMISIONET E NDËRMJETËSIMIT

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 189, datë 26.10.2021

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i nivelit maksimal të komisioneve të ndërmjetësimit nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik në sektorin e transportit.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga të gjitha shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës si dhe ndërmjetësit e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, që ushtrojnë veprimtari në sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

Termet e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e përkufizuar në Ligjin nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 7, pika 6, të Ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Neni 4
Komisionet e ndërmjetësimit

1. Komisionet e ndërmjetësimit janë komisionet e paguara ndërmjetësve si pjesë e shpenzimeve të marrjes në sigurim, për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik.

2. Shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, nuk mund të aplikojnë në total komisione ndërmjetësimi, për çdo policë të shitur, më të lartë se:
 - 20 % e primit të shkruar bruto, nga 1 janari i vitit 2022;
 - 18 % e primit të shkruar bruto, nga 1 janari i vitit 2023.

Neni 5
Pagesa e komisionit të ndërmjetësimit

1. Pagesat e komisioneve të ndërmjetësimit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit duhet të kryhen vetëm nëpërmjet transfertave bankare në një llogari të veçantë të ndërmjetësit.
2. Në asnjë rast, komisionet e ndërmjetësimit nuk duhet të jepen nga shoqëria në formën e paradhënieve ndaj ndërmjetësve.
3. Ndërmjetësit nuk mund të kërkojnë pagesa apo komisione nga i siguruari.

Neni 6
Raportimi i shoqërisë së sigurimit

Shoqëria e sigurimit raporton në Autoritet me baza tremujore brenda muajit pasardhës, si pjesë e raportimit financiar periodik, shpenzimet e komisioneve të ndërmjetësimit për periudhën raportuese.

Neni 7
Dispozita kalimtare

1. Të gjitha shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e Jo-Jetës janë të detyruara që brenda datës 31.12.2021 të përshtasin politikat dhe procedurat e tyre të brendshme lidhur me komisionet e ndërmjetësimit, në përputhje me kërkesat dhe kufizimet e kësaj rregulloreje.
2. Shoqëritë e sigurimit fillojnë raportimin në Autoritet, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, për tremujorin e parë të vitit 2022.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 1 janar 2022.